

DEKRET
Nr. 7847, datë 3.12.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR. 6201, DATË 8.6.2009 TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR CAKTIMIN E KOMPETENCAVE TOKËSORE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE DHE TË QENDRËS SË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË SECILËS PREJ TYRE”

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 paragrafi 3 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Në dekretin nr. 6201, datë 8.6.2009 të Presidentit të Republikës “Për caktimin e kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së secilës prej tyre”, bëhen këto ndryshime:

Në nenin 1 në pikën 15, fjalët “Bashkia Leskovik” hiqen.

Neni 2 shfuqizohet.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi më 1 janar 2013.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani